

A DUHET TË FOTOGRAFONI DHE SHPËRNDANI NË RRJETET SOCIALE KARTËN TUAJ TË VAKSINËS?




Ndarja e fotos të kartës tuaj së vaksinës kundër COVID-19 në rrjetet sociale është trendi i momentit. Kjo i tregon të gjithëve që keni bërë të paktën një dozë të vaksinës. Ju nuk duhet ta ndani provën tuaj të vaksinimit. Ka informacion të vetëidentifikues të rëndësishëm në kartë.




Nëse nuk jeni të kujdesshëm, njerëzit mund të vjedhin identitetin tuaj. Ata mund të krijojnë versione të falsifikuara të kartës së vaksinës. Kini kujdes, karta juaj e vaksinimit përfshin informacione personale si emrin tuaj të plotë, ditëlindjen, llojin e vaksinës dhe vendndodhjen ku keni marrë vaksinën tuaj.

DISA IDE TË SIGURTA PËR T'U TREGUAR TË TJERËVE SE KENI BËRË NJË VAKSINË:




Nëse merrni një broshurë, pasi keni bërë vaksinën, më mirë ndani një fotografi të saj.



Vendosni një kornizë rreth fotos së profilit tuaj në Facebook, që tregon se jeni vaksinuar.



Rishikoni cilësinë e sigurisë, në të gjitha llogaritë tuaja të mediave sociale. Bëni kujdes dhe sigurohuni që vetëm njerëzit që dëshironi ju, mund ta shohin llogarinë tuaj.



Bëni kujdes nga kuicet në Facebook. Ato mund të mbledhin informacione që shpesh mund të përdoren si fjalëkalime ose pyetje sigurie.

Ky dokument është përgatitur nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në kuadrin e projektit " COVID-19, Reagim Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar", të mbështetur financiarisht nga Ballkan Trust for Democracy(BTD). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e BTD.

Për të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe Covid-19, ju mund të lexoni materialet e publikuara në faqen tonë: <https://platforma-pak.al/te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-covid-19/>, ku keni dhe hapësirën e posaçme dedikuar për pyetjet tuaja.